



**UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA**  
**DIPARTIMENTO DI LINGUE E SCIENZE DELL'EDUCAZIONE**  
**LABORATORIO DI ALBANOLOGIA**  
**UNIVERSITETI I KALABRISË**  
*DEPARTAMENTI I GJUHËVET DHE I SHKENCAVET TË EDUKIMIT*  
*LABORATORI I ALBANOLOGJISË*



Opere di Francesco Antonio Santori

a cura di

Vincenzo Belmonte

# FRANCESCO ANTONIO SANTORI

## [KLEMENDINA]

[Vetëtë]

Klemendina [15]  
Sofia  
Kushedra  
Llizi  
Mënallipi  
Dila  
Allfonxi  
Ifixhen'ja  
Tëdhidhi

[Atë i parë]

Shënë e päre

*Kushedra vet*

Mote dishërome, gjëllë e spavurë, kurë  
kopile gazullore meje prapa  
sisonja llojë trima që lutoin  
formadhen bukuri që më nderoj,  
së priri më për mua, më nëng sisonjë 5  
nga menata shkëllqiem diellin e but  
që natën dishërova se të vij  
njinje të dilënja tas nga dritsorja  
e ruonja ndomos shkoj trimi ç' u donja.  
Së më këndonjë para të buthtonet 10  
arva te gharaksia e zënë këshet  
së pjeksinjë më me bardhe xigharele.  
Popo, m' u bardhsua. Së biarë njeri,  
jo pjak, jo trim, mbi të një ruare. Faqja  
ime koillormë e holle që një mot 15  
e bukuris ishë pasiqira monu  
ninen ani buthton pasmes ghavnë  
aruame e pjono udh! Na fjuturon  
ashtu më se puhjia moti njinje!  
E prana së qëndron neve të mjera 20  
se vidhja që na vret pr' ato kopile  
kuj shomi gjatharë, kuj qeshën jeta. [16]

She' si shkëllqen, she' si m' i qeshën siu  
 kësaj kopile fanizore e këmba  
 së ndian ashprin e udhës. Ndoçë ambnore 25  
 zëen e kâ, t' i vë keqe jushtrî.  
 Ndo kâ jushtrinë, u të shurbenem aqë  
 kam t' e bënjë gjakore, të paguanjë  
 shamen çë bëri mua me t' atin jëma,  
 kūrë vashë për të m' u dogjë mjerës ndë gjī 30  
 zëmra pa një levrom. Nani m' arvon  
 hera lutome të minitse e dashe.  
 Qasu, qasu, kopile, ti të jeshë  
 vendi ku rri të bjërë e times dīrë  
 përkeqja bumbullim. 35a

## Shënë II

### *Kllemendina e Kushedra*

[*Kllem*] Gëzomu, via, 35b  
 Kushedre mīrë. Thuame çë kē çë ndian  
 e vetme fjet. Çë mällë të llastimisën  
 shpirtin? 38a  
*Kush* Mos t' e dishë fare, kopile, 38b  
 këshillin [ç'] merëngon mua varthen pjak!  
 Noeronjë se kūrë si ti jësja ndë vjet 40  
 trima e fuqiruze, por me gjith  
 se ndianja ndë stomachjë një zjarr sëshōrë,  
 duronja nd' ato shtrepe edhe pjaxhīrë  
 tue xënurë se shërtoj një trim për mua,  
 se i shpitej faqes posht një lot hajdhie, 45  
 ndo më sisoj. Nani tas e lëshome  
 së jam ruare njeriu e vidhje mbanjë  
 vashave çë ngë don ndë trimērī,  
 kurë moti lulëzon, i qeshën e dheu.  
 Arvon prana pjakria e së ndilguan 50  
 gjellën çë qe, spavurë si gjum përpara  
 sive. 52a  
*Kllem* Kushedre, a, mos kujto, via, më 52b  
 këto sfanmire mote çë ndë zëmërë  
 së lën mose jushtrî.  
*Kush* O vashë, ti nëng e dī 55  
 fuqīnë madhit amurë se nëng e njohe.  
 Njihe, se prana thua  
 ndo ëmbëla jan thartitë  
 çë keqëthi dhjanemon,  
 se mbrënda i lë të liga, 60  
 moj jashta i bukuron.

[17]

*Kllem* Jo dī, jo dua të xë  
 pjaxhīret e spjaxhīr' çë jep namuri.  
 M' i tha, m' i tha Sofia,  
 se tekun arvon amuri ikën ambnia. 65  
 U shprishtin delet, popo! Njize vete  
 t'i mbjedh, ndomos më zbiret ndonjë kaciqe.

Shënë III  
*Kushedra vet*

Shërtoi, u nguqësua, mbulliti sītë,  
 faqen verdhoi e s' dij të fjit e, prana  
 çë noeroj një gjate cop, duk se ne shkuli 70  
 nga zëmra ato fjalë ndrequra thomse,  
 me larte noerī ndërruara ashtu,  
 e tha me gjuh atë çë zëa së kã!  
 Së njoh vashat si jan? E xura, e xura.  
 Ndë bállë, ndë sī u zëen i dhjavasa: 75  
 ndë zëmërë gjegjën amurë ajo kopile.  
 Për kë ng' e dī, moj kam të tërjollonjë  
 njera ç' e shoh me sī e prana e shpinjë  
 ndë keqi det ku zallë prë mot së merr.

Shënë IV  
*Sofia, Kushedra mbë pjes*

[Sof] Ghanjun i keqë, ghanjun ndë gjī pa zëe, 80  
 për një pjaxhīrë pasosme prana jep  
 shpjaxhīreshë o atë c' i dha tharton  
 me milë spjaxhīre më të zeza e gjata  
 o fare nëng i jep o shkrehën e ikën  
 prana pa lipsī nga vëlumuori. 85  
 Ghanjun pa zëe, fuqie s' mundorë! Njerī  
 s' e lidhi, monu shuajti, çë kurë dolli  
 nga dora fuqiruze madhit Thē  
 dheu, vambën [çë] lavosën burra e grã.  
 Bën e kopilin pë, 90  
 më shtiti tas ndë gji  
 një mällë i gjerë për të, prana merome  
 sholes prej më la. "O do o bie",  
 më tha, moj desha e rë.  
 O, Lliz, ti rrī ndë hjë, 95  
 shërton për tij Sofia,  
 shurdhurë buthtone ti ndë keqe mia  
 e së përgjegje, e zëmëra gjë së thot. Qot  
 çë qot! Ka vjen kjo thamasjuze zae?  
 Ka timet shtrepe kã thomse lipsī. 100

<p>Popo, si mund duronjë mbë mua fuqia,  ndo zëen e k̄a ai ngurte si gūrë  e së ndillgon amurë, moi mua nodhjon?  Rrangon rrasu ka u. Do t' thuashë se monu  ninen e mī mund shoh e aqë i jam  atij u mjere zilize?</p>	105	
<p>Ku vete njize vetme, tas lëshome  e zbjerr si sqep te ndina? Kllemendina!  Popo armiken ti ture kujtuarë  më vete për kë jam pather dhëmbosome  e, ndomos ishë ajo, së m' ikij Llizi  ghrellë kūrë e sisonja.  Çë donje sa t' u bënjë? Së më qëndron  mua s'ellpizome më jatrī se dekje!  E mua mbī se të thon: "O, tas na vate!".  Fate s'fanmīrë, si pather qe me mua  keqe e s' u buthtua një hērë gazore!  Si mund ambnore jam ndo kam ndë zëe  vambën amuri gjith çë mua brezon?  Finxhon' e dī kushë ndian amurë. Moj fare  vëlen kjo finxhonī  me atë çë kroi është timve shtrepī.  <i>Kush</i> Jam u, bardhe kopile,  bukur, larte Sofi,  jam u çë fjas me tij, jo më njerī.  Më nget një gjërë spjaxhīrë  prë tëndet stespasī, fanmire vashë,  e s' mund të bënjë u gjë  se thomse ndë të fjas  dhëmbimin zgjonjë çë fjë.  [<i>Sof</i>] Kushedra, tas çë xure  ka vjen dhëmbima çë lavosën gjīnë  e zëen mbjatu m' e shqiarë,  mbësom prë lipsī,  mbësom, ndo ndian amurë, ti ndonjë jatrī.  <i>Kush</i> Vërtet sa amuri bashkësuarë zilīs  për zī bardhin e merr e keqi duket  juve kopile mīrë. Pra kūrë ndillgoni  ligat e spjaxhiri  çë duhen se t' arvonjë prana pjaxhiri,  së ju buthtonet mīrë.  Ndo ti dunga taksen se të bëshë  atë gjith [ç'] u të buthtonjë,  armiken Kllemendin  përpara sī t' e nxīarë e nga ki dhë  bë t' njize fjuturonjë  pa farmëkë e pa jatrī e tëndin bënjë  Llizin ghavnārë.</p>	110 115 120 125 130 135 140 145 148a	[20]

<i>Sof</i>	Çë zëmra të dishëron,	148b	
	Çë maj noeri të vulon e qotë		
	mirë, lig o përkeqë	150	
	se gjith e bënjë të kem u Llizin dreqë.		[21]
<i>Kush</i>	Gjegjëm e shkruaj nd' oreks atë ç' u thom.		
	Mbë gjith shurbemu se t' xënjë Llizi		
	se Kllemendina diqë, se mjeri, marr		
	ka malli sajës dashë, te vendi vete	155	
	ku mjera xu se diqë e bën të gjënjë		
	sqepin e shqerr me gjak të lagtë e pjon		
	dhëmbat. Atje rrī shehurë u të, kūrë		
	arvon, vëhem përpara e t' e mbanjë		
	se t' mos vritet, zë t'ahiara i thom	160	
	se nj' etrë vashë e doj më se përdasha		
	vëdiqe Kllemendin.	162a	
<i>Sof</i>	Popo, rrī qetu.	162b	
	Allfonxi këtu vjen. O, sa kī trim		
	ë mua nodhjuz! Sa më t' i rrinja ghrëllë		
	u donja, afrë i jam. Çomu, se prana	165	
	o edhe menat, më nje të dialli dalë,		
	gjëndemi na papā te vendi ku		
	jemi nani e më mbëson çë bënjë		
	më toket se të kem përdashin Llizi.		

## Shënë V

### *Llizi e Sofīa*

<i>Llizi</i>	Sofi, Sofi, mos ik! Kī, via, një herë	170	
	ka u mjeri lipsī! Më dispillejon		
	më se gjaksorë armik e monu ndianë		
	timet shërtime e, ndo të parkalesinjë,		
	dhiruze fluturone. Popo s' munda		
	kinja pjaxhirin të një herë qëndroj	175	
	mbi meje me të zīnë shkëllqiemī sī		[22]
	një ruame folësore. Monu pata...		
	Sa hërë përpara tij përgjunjurë rē		
	e mora tij podhënë tue parkalesurë,		
	një fjalë së ndiajta, dalë ka labri tū	180	
	ëmbël e kuqë, çë jip një pik levrom		
	varthit. Lepothmeva e së më ngrëjti		
	bardha jote dorë o, marr lipsie,		
	shprishi një pikez uj ndë ballë skoillorme.		
	Çahej një gurë ndë mī shërtima, losej	185	
	një hekurë nd' atë zjarr çë siallën lart		
	një mī sëluc ka thelli zëes e vet		
	jotja dhëmbine s' ndian o stespasī.		

Ndo jo shërtima, s'ellpizime e amurë , ndë jo këndima, jo vajtime patin harënë të shpijin mbrënda nd' at stomahjë një pik nga zjarri çë m' lavosën gjinë, qoshin këto martri se të buthtonjin me shkëllqeme drit përpara tënde sī derdhura lot.	190     195
Egrë e sa tharte është dhëmbima ime u vet e njoh e mosnjeri çë ng' është ndë thëllë të zëes e mī sqerr e vëlo more. Ndo mundnja allmëngu nga këshilli mjerë ninen e tū t' e fjuturonja ghrelle së ndianja stespasī s' ani dhuronj. Si veshurë ngrah m'u vū e rrī përpara trū	200     [23]
si drita hapta sī së vrëhet o perndon, ndo mīrë ti rrī. Ashtu kjo nina jote së më lë, ndë nata më tharton gjumet e leza me ëndërra pak hareme, moj të pjota trëmbime. Detet mbjon me zeze shtrepe e vet një kred së më gjeron pushimi.	205     210
Ndo së të shoh, mua, si jushtrorë tramaksa me veshura të shqerra e verdhësime nga dheu çonen jushtris ç' ë tas e zbjerre e priren pjono gjak gjimsa dekōrë të thon ndë tjerve shpī se ran proposhë e tirja gjind e ashtu varthet gropsonjin prind ndë zeza lipe, timet noërë prien ashtu s'fanmira. Ndo të shoh, më rriten s'pasitëtë pse me zëmërë s'lipsjare, më se ullku lutëm shqīarë shtjerrin, m' e vëlo mon timen merome. Nd' e vritnje, allmëngu s' kisha keqë spjaxhīrë. S' e vret e s' e shëron, moj me dhëmbim e rron	215           220
të bënë duruarë një stespasuome gjellë, një shtrepasorë vëdekje, o ilë, o qiëllë! <i>Sof</i> Dije se së të dua. O des o nëng vëdes, s' kam lipsī nga ti më se kërshterë, e nëng më pīarë jo qarë, shërtim, ngales o parkalese. Pandehjërë nëng e gjegje, ndije nani më mirë	225       [24]
se s' kam ne pata maj për tij pjaxhīrë. <i>Allf</i> Popo, [mix]ore! Ashtu zëen m' e shqīarë çë dridhet gjith prë tij. A, ti ngë do, se ndo vërtet ndë gjī ndillgonje zjarr	230   235

prë ndonjë kopilë, edhe se ng' isha u mjeri,  
 bënje si bën s' lefteri  
 me shokun e një rrëmb sqepsuarë lipsije  
 buthtonje. 240a  
*Sofia* Mos e prit! T'e thash e thom 240b  
 se t' kam nodhje ne mund të gjegjinjë më.  
 Qëndro ati, se vete ani e të lë.

Shënë VI  
*Allfonxi vet*

Më foli allmëngu. S' qe si tjera herë  
 çë m' iku si ghanjuni, sa më pā,  
 tramaksurë ka farmëkore drangolë 245  
 sikurna o trëmbtuarë lugadhe t' zes.  
 Ma ata shtrepet e mī  
 ambnore nani më gjegji kurë shërtonja.  
 Lotet ç' u ng' i shinja  
 thajtura mua ndë faqen 250  
 helmore e zezullore  
 m' i vreti me një vjedhtare të ruome.  
 Dhe ki, ndorrina se  
 i shkurtërë, qe prë mua një madh pjaxhirë,  
 të rrinja afrë saj një kred i vet, 255  
 njer' sod pather shërtuorë e maj i ardh',  
 të ndinej sa duron zëmëra amurë.  
 Thomse fani më priret  
 meruarë ka stespasitë çë shkova mjerë.  
 O qiellë, ndo llastimisa ndonjë herë 260  
 e fola kundrë tij prë zeze dirë,  
 mundurë nani, vinxhuarë [25]  
 madhes kllemenxje tū, pjonu harë  
 nde shtrepe anamesa  
 prë levromin [çë] më dhë të doksjonj, 265  
 rrëndirinjë pasitë  
 pather e metanosemi nga stesa.

Shënë VII  
*Kllemendina, Llizi*

[*Kllem*] O madh harë! Monu besonja mua  
 një kred si ki ghavnarë e pjaxhiruz.  
 Të shoh mbë sos allmëngu. Ësht e vërtet:  
 jë ti, o Llizi. Sa hërë m' u fjuturove! 270  
 Buthtuarë e shkapërdiksuarë qe një kred.  
 U zeza merëngore



erdha pas tij e së t'arvova maj se nani vet. O dishëruame herë!	275	
Sësosma nëng e pā, me më hajdhī pjonu si kī, nj' etërë më fanisōrë. Mund ellpizonjë të jem dashërë ka zëa ghavnare jote? O kam trandakse edhe duronjë ndë stespasī. O monu qot se t' fanaroset kī noerë përkeqë si nina nd' uj.	280	
<i>Liz</i> Pather ti, Kllemendin, frima e gjelljes time, m' i tharton harëtë shërtome çë më jep onjaqë. Dije se jē mbrezorja zëes e mī.	282a 282b	
Ti jē fuqia çë tas më mban mbi dhē, ti sësosmi këshillë, ti bukuri, formadhë, shkëllqemthi illë teku dhjvasinjë u prasmēt harē.	285	
Ndo ti pas meje vinje nd' ato të merëngore qetëmī të Farnitit i zī e vetëm nd' ato vota mjerë me dele, ti më sisonje e ndianje se jo jetrë bumblizon për nd' ato lume e pila e llaka e rehje sa një zae helmōre karramunxave mī çë jo më gjë këndonjin se ghavnaren Kllemendin.	290	[26]
Delet i harronjë u cado hērë, arvon Mēniti, çë ti tas e dī si m' e mbësōva, e më lipīn me gjuh, më nget me këmb e ndihemi si kūrë patakset një nga gjum i thellë e gjat. Delet e shprisha mbjedh, gith marr noerit tëndes formadh e larte bukurī.	295	
E zëmra tij të bën të piash ndo u të dua? Ti ng' e buthtove si u ndo deshe mua. <i>Kllem</i> Popo, [ti] nëng e dī se zëmërat çë don pather trandakse buthtonen e pandehnjjin trëmbësime. T' dashëre është të jënë pather sbesōrë. E gjella tirë shërtime, zilī e të pushonjin ambënies të ghrella, pather me një frëshëllim ndë gjī çë zëen i hā e lipsī për mot s' buthton o kā. Siso, siso proshë te lumi. Njoj se vjen pjaka Kushedre.	300	
Më qasi jetrën hērë	305	
	310	
	315	
	320	[27]

e dalë e dalë më pija ndo u të donja.  
 U ja rremova, moj nani na pā  
 të di vetëm këtu. Tas s' mundmi më  
 të thomi jo, nani çë na prosteksi.  
 Ecën njize t' arvonjë. E presmi o vemi? 325  
*Lliz* Rrimi si mbe'm e kūrë të vinjë i thomi  
 se është e para hērë  
 kjo ç' u kundreluam te këto pila  
 me dele na të veta e më s' u pam.

Shënë VIII  
*Kushedra e thëntë*

[*Kush*] Fanmira shok, gëzoshi, sa dhuron 330  
 gjella, pather me gaz. Për ju tas bīnë  
 jëta lulet më koillori piksa  
 e dherat na buthton të barësore  
 e bardhe e gjellbullore.  
 Jo më për neve mjera 335  
 pjaka çë shkuam e vam e monu nina  
 neve qëndron të pasmave hajdhī  
 si ëndërra fjuturome.  
 Allmëngu jam levrome  
 se duhi tas ju trima e kam pjaxhīrë 340  
 se siprë gjith tij, Kllemendin, dua mīrë.  
*Kllem* Kushedre, pasitë  
 rrëndirinjë prë sa më ndë zëmërë kam  
 prë namurin [çë] më solle. Moj ndëlem,  
 ndo të shpëllqeva, se kopile jam 345 [28]  
 e çë të bënjë s' e dī  
 e mīrë edhe së njoh ç' ë namurī.  
*Kush* Jini ghanjun vërtet. U ju ndëlenjë  
 edhe bëja kështu kūrë isha u vashë  
 e zjarrin do t' e shehnja ç' ishë ndë gjī, 350  
 moj më bënja fuqī se t' e buthtonja,  
 kundrela gjithve e vënja  
 e tas një vend ng' e gjënja  
 të mundnja mirin tim vetëm sisonja  
 çë me nodhjuz spjaxhīrë 355  
 pjaxhirin çë më jip nëng e thartonja.  
 E s' pata, burr o grua,  
 një pjak të m' vuliroj ndë time bëma  
 si juve, kuj fanmīrë  
 fata qeshën pjonu gaz, jo dīrë. 360  
*Lliz* Kushedre, na magjepse me këto thëna  
 e zëmrën pa t' e dojim na e zbulove,  
 pëse si deshe arvove

te më thelli noerë ç' oreksja kishë.  
 Namurin tën e pë 365  
 e njohe se, ndo kam frimën ndë gjī,  
 e kam prë këtë kopile  
 çë neve afre rrī me gjith se mëma  
 e tata s' don t' e ruonjë monu çë llarghu,  
 moj vet vëdekja s'lipsjare mundën 370  
 ka zëmra të m' e nxjerë  
 ndomos u s' e harronjë nj' e vetme hërë.  
*Kush* Vërtet gola së thot sa zëmra ndian  
 moj u çë shkova nga kto udh ndillgonjë  
 sa është e gjat, e shkurturë na e buthton 375 [29]  
 ëmbëli amūrë, e pjonu gjëmbe prana  
 e gjën i mjeri trim ç' e këmbson.  
 Moj bëmi të trëmbima llarghu rrjerë  
 ka gjiu e mos harromi  
 se moti grisën male pila e lume 380  
 e llakat rehje bën e rehjet llaka  
 e besa mbarë prë mot me fuqiruze  
 ellpize gjën mbë sos dashen hajdhī.  
 Sa mundën ndihma mī së ju lëshon  
 e prindve tū i bumblison ndë veshë 385  
 një fjalë ambnore se të kenë pjaxhīrë  
 për këtë kushqī. Shërbenemi jo pak  
 t' ulinjë vëlomën e tire se të den.  
*Kllem* Atë miri [çë] na bën, Kushedre, neve  
 Theu tas t' e rrëndon mbë pjakëri. 390  
*Kush* A, ngë njohtë edhe ju zëen e mī.  
 Kjo është imja harë, imi pjaxhīrë  
 të pather miri jam trimave dheu  
 e më rrëmbeu mbë gjith  
 namuri çë mbë një zëmrat ju lidhi 395  
 e ahiara kam harë  
 kūrë bashk ju shoh të di dhëndërra mbë hjë.  
 Duhi e mos hjimisi  
 se moti vjen kūrë mënd të trashigoni  
 e shtrepet e hjidhitë gjith i harroni. 400  
*Lliz* O Kllemendin, së ndian? Lehën Mënit  
 proposhë ka llaka. Thomse ullku dolli  
 te sheshi nga Farniti.  
 Vemi njinje! Kushedra na ndëlen  
 nd' e lëmi, se ndomos delet na shqīarë. 405 [30]  
*Kush* Urata çë dishëroni pather art  
 me jū e mos ju fjuturot ka gjiri  
 prë mot harea e lutmes namuri.

Shënë IX

*Kushedra vet*

Ashtu, ashtu ju dua! Më qeshën zëa  
si [i] qeshën jënsë, kūrë sison të ngrën, 410  
se moti afrësonet të paguanjë  
shtrepet që lekostin timen gjellë  
për shamen që më bëri ai hjidhjori  
përkeqi Mënallip. E njoha, e njoha,  
e pë me sī, me dōrë ngava namurin 415  
që kan ndë gjī të di këto s'fanisōrë  
kopilë e zjarrit afrë qasa drū,  
i dhezurë se të djeg me më fuqī.  
Trima s'fanmirë, tek një rrënje zūt  
s'lipsjare ku, ndë tundi, ngatarrehi 420  
si ng' ishit pak përpara. Ju gënjeu  
i ëmbëli foljë që tas farmëkun ju jep.

**Atë i ditë**

Shënë e pārë

[31]

[*Sofia e pra Kushedra*]

[*Sof*] Llaka, male, rehje, pila, dushqe,  
sheshe, zalle, lume, luca, kronje,  
erve, qënda, bare, lule, s' kini 425  
ghuanjunin e ziluz të fjuturonjë  
pushimin me k' bëgatja shum tjure  
pather ju lumson. Prë mot ambnore  
trashigoni pa jushtre e pa hjidhī  
gjellën që juve dha s'mundori Zot. 430  
Ndo shkon puhjia, ju zgjidhni ndë harë  
një gaz që ju shëron vulomat [çë] bëri  
vorea borsome, e, ndë menat thellëza  
ture kënduarë tëfalën ditën e zogu  
te dega ervit llastimisurë pendat 435  
këndimen shkon me kë tëfalën diellin,  
juve hajdhonjin, jo të mjeren mua,  
kuj pather ndë këtë gjī  
s'hareme kequllore  
namurja rronisorë pather më rrī 440  
e prë të ngrën më jep  
lot, shërtuara, trëmbstime e shtrep

[.....]

# FRANCESCO ANTONIO SANTORI

## [CLEMENTINA]

[*Personaggi*]

Clementina  
Sofia  
Kushedra  
Liso  
Menalippo  
Domenica  
Alfonso  
Ifigènia  
Tidide

[**Atto I**]

Scena I

*Kushedra sola*

Anni rimpianti, vita dileguata,  
quando lieta vedevo appresso torme  
di giovani anelanti  
il pregio dell'altera mia bellezza,  
più per me non tornate, più non scorgo 5  
al mattino splendente il mite sole,  
invocato la notte perché subito  
spuntasse e mi affacciassi alla finestra  
in attesa del giovane che amavo.  
Io più non canto prima che si mostri 10  
l'alba ad oriente né più avvolgo in candidi  
nastri la nera treccia.  
Ahimè, mi si è imbiancata. Chi mai spreca,  
uno sguardo su essa? Il volto mio 15  
già delicato e colorito, un tempo  
specchio della bellezza, nulla serba  
della goduta leggiadria, dorata,  
aperta a mille vie! Vola lontano  
il tempo, più rapido che brezza!

Solo resta a noi misere l'invidia  
rodente per fanciulle cui sorride  
gaia la vita. 20

Ve' come splende, come brilla l'occhio  
a questa fortunata che l'asprezza  
non sente del cammino. Se pacato 25  
ha l'animo, glielo scompiglierò.  
Se ha già scompiglio, a renderlo cruento  
mi adoprerò, che paghi  
quell'onta che subii da madre e padre  
quando per lui nel petto di ragazza 30  
aspro amore bruciava. Or giunge l'ora  
dell'attesa vendetta.  
Accostati, ragazza. Su di te  
del mio furore già sta per piombare  
la folgore malvagia. 35a

Scena II  
*Clementina e Kushedra*

*Clem* A te salute, 35b  
buona Kushedra. Dimmi come mai  
parli da sola. Quale cruccio affligge  
lo spirito? 38a

*Kush* Per te meglio ignorare 38b  
il tormento di vecchia sconsolata.  
Pensavo ora che, come te negli anni 40  
giovanili e possenti, benché in petto  
fuoco ardesse inestinto,  
provavo in quelle pene anche piacere,  
se per me sospirava un giovane, se lacrima  
di gioia gli rigava, 45  
al vedermi, la gota. Or derelitta  
nessuno più mi sbircia e porto invidia  
alle ragazze in fiore che non amano,  
quantunque con l'età gli rida il mondo.  
Ignare poi le coglie la vecchiaia 50  
della vita trascorsa, come sonno  
svanita. 52a

*Clem* Più non rievocare 52b  
questi tempi infelici che nel cuore  
non lasciano che guerre.

*Kush* Nulla sai 55  
tu della forza del potente amore.  
Conoscila e dirai  
se sono dolci i triboli  
che il malvagio dispensa,  
per sé duri, incresciosi, 60

abbelliti di fuori.

*Clem* Non so né son curiosa  
dei regali d'amore.

Me li ha esposti Sofia:

dov'è amore, la pace fugge via.

65

Ah, vado a radunare il gregge sparpagliato  
prima che qualche agnello si smarrisca.

### Scena III

#### *Kushedra sola*

Sospirava arrossendo,

gli occhi ha socchiuso, poi incerta, pallida,

dopo lungo silenzio ha tratto fuori

70

dal cuor quelle parole forse finte,

consegnate abilmente e con la lingua

ha smentito il pensiero.

Non conosco le giovani? Ho capito.

Nel volto ho letto l'anima:

75

in cuore prova affetto la ragazza.

Non so per chi, ma indagherò finché

non la vedrò con gli occhi per poi spingerla

in mare iniquo da cui non s'approda.

### Scena IV

#### *Sofia, Kushedra in parte*

*Sof* Quel putto manigoldo senza cuore

80

scambia con serie eterna di afflizioni

un fugace piacere o lo amareggia

con mille dispiaceri lunghi e neri

o piacere non dà ma scocca e fugge

senza pietà lontano dal ferito.

85

Putto invitto spietato. Mai nessuno

lo legò né, da quando dalla mano

potente del gran Dio sorse la terra,

la vampa spense ch'arde donne ed uomini.

Alla vista del giovane, nel petto

90

vivo amore ha versato, poi lasciandomi

sull'orlo dell'abisso.

"Ami o precipiti"

mi disse. Ho amato e son precipitata.

Liso, tu stai all'ombra,

95

per te Sofia sospira.

Sordo ai suoi mali, taci

e muto è il cuore. Sia

come sia! Donde viene questa voce

misteriosa, indulgente ai miei dolori?

100

Ahi, come in me può rimaner la forza,  
 se lui l'animo ha duro come pietra  
 e non intende amore e mi detesta  
 correndo via. Vuoi dire che nemmeno  
 sopporta la mia vista e tanto odiosa  
 gli son io poveretta? 105

Dove vado ora sola, abbandonata  
 qual velo appeso a un palo. Clementina!  
 La nemica mi evochi,  
 fonte d'ogni dolore. 110

Senza di lei, non fuggirebbe Liso  
 lontano dai miei sguardi.  
 Che fare? Non mi resta  
 rimedio se non morte disperata.  
 E su di me diranno: "Se n'è andata!". 115

Destino avverso, sempre a me funesto,  
 non una volta amico!  
 Come essere serena, se nell'anima  
 vampa d'amor mi doma?  
 Chi amor sente sa fingere, ma niente  
 vale questa finzione 120

con colui ch'è sorgente d'ogni pena.  
*Kush* Son io, fanciulla candida,  
 bella, alta Sofia,  
 son io che con te parlo e nessun'altra. 125

Mi dispiace nell'intimo  
 per i tuoi duoli, prospera fanciulla,  
 ma esserti d'aiuto non è facile  
 perché se te ne parlo  
 ridesto l'inquietudine assopita. 130

*Sof* Kushedra, or che hai inteso  
 donde viene il dolore che ferisce  
 il petto e strappa l'anima,  
 insegnami, ti prego,  
 se provi amore, insegnami un rimedio. 135

*Kush* È vero: amore, unito a gelosia,  
 per nero il bianco prende e il male sempre  
 per voi ragazze è bene. Poi, capendo  
 che a mali e dispiaceri  
 il piacere è legato, 140

un bene non vi pare.  
 Se prometti di fare  
 tutto ciò che ti ispiro,  
 ti toglierò di torno la nemica  
 Clementina e dal mondo 145

la farò volar via  
 senza veleni e farmaci e il leggiadro  
 Liso tuo renderò. 148a



<i>Sof</i>	Ciò che tu vuoi	148b
	e il pensiero consiglia, e buono sia	
	oppur malvagio o pessimo,	150
	tutto io farò, pur di strappare Liso.	
<i>Kush</i>	Sentimi e incidi in mente quel che dico.	
	Adoprati perché si annunci a lui	
	ch'è morta Clementina. Così il misero,	
	preso d'amore per l'amata, al luogo	155
	accorre del disastro e troverà	
	di sangue intriso il velo lacerato	
	a dentate. Nascosta lì, mi presenterò	
	al suo arrivo a impedirgli	
	di uccidersi svelandogli che l'ama	160
	una ragazza più dell'adorata	
	defunta Clementina.	162a
<i>Sof</i>	Taci! Arriva	162b
	qui Alfonso. Oh, questo giovane	
	troppo mi è odioso! Quanto più lontano	
	stargli vorrei, gli sono vicina. Va',	165
	ché poi, anche domani, avanti l'alba,	
	nel posto ci troviamo	
	dove siamo e mi insegni cosa fare	
	per legare a me Liso.	

Scena V  
*Alfonso e Sofia*

<i>Alf</i>	Non fuggire, Sofia! Pietà per una volta!	170
	Tu mi disprezzi più che sanguinario	
	nemico e resti sorda	
	ai miei sospiri e, se ti prego, via	
	rabbiosa te ne vai. Mai m'è toccato	
	che una volta su me si soffermasse	175
	con l'occhio nero splendido	
	un tuo sguardo parlante. Né mai ebbi...	
	Mai, supplice dinanzi a te, afferrando	
	la tua balza, ascoltai una parola,	
	uscita dal tuo labbro dolce e rosso,	180
	che un po' desse sollievo	
	a me infelice. Svenni e la tua candida	
	mano non mi soccorse né pietosa	
	versò una goccia sulla fronte pallida.	
	Si spezzava una pietra ai miei sospiri,	185
	un ferro si scioglieva nel fuoco che singhiozzi	
	dal fondo dell'anima eruttava,	
	solo la tua non sente duolo o pena.	
	Se non sospiri, amor, disperazione,	

se canzoni o lamenti 190  
 non valsero ad infondere in quel petto  
 una fiammella del fuoco che m'arde,  
 le lacrime versate siano almeno  
 provati testimoni  
 davanti agli occhi tuoi. 195  
 Selvaggio e amaro, io solo il mio dolore  
 conosco e nessun altro che non sia  
 tra le piaghe dell'anima.  
 Potessi almeno dal pensiero misero  
 far volare lontano la tua immagine! 200  
 Non sentirei le pene che ora sento.  
 Come un vestito mi si è messa indosso,  
 sta davanti alla mente come luce  
 agli occhi aperti e mai, se tu stai bene,  
 s'intorbida o tramonta. 205  
 Così quella m'insegue,  
 se lieve quiete la notte amareggia  
 con sogni odiosi ed orridi.  
 Di cupe pene i mari  
 empie e non porge di riposo un attimo. 210  
 Se non ti vedo, a me, come soldati  
 pallidi di paura e in vesti lacere  
 vengono dall'esercito sconfitto  
 e, quasi a morte sanguinanti, annunciano  
 i nomi dei caduti, sotterrando 215  
 i genitori miseri  
 in neri lutti, così i miei pensieri  
 tornano a me infelici. Se ti vedo,  
 mi si accresce la pena, ch  spietata,  
 pi  che vorace lupo non dilaceri 220  
 l'agnello, mi ferisci il cuore afflitto.  
 Se lo finissi, pi  non soffrirei.  
 Invece non lo uccidi e non lo sani,  
 ma in duolo lo fai vivere  
 onde inasprire una vita scabrosa, 225  
 una morte straziante, o stelle, o cielo!  
*Sof* Sapevi che non t'amo.  
 Che tu muoia o non muoia, non m'importa  
 di te che da cristiana e non mi piega  
 accusa, pianto, supplica o sospiro. 230  
 Se poi non l'hai udito in vaticinio,  
 sentilo chiaro adesso  
 che in te non provo n  provai diletto.  
*AIf* Ah, crudele! Cos  mi strazi il cuore  
 trepidante per te. No, tu non ami, 235  
 ch  se in petto provassi vero fuoco  
 per un qualsiasi giovane, faresti

come con il compagno il prigioniero  
ed un raggio velato di pietà  
mostreresti. 240a

*Sof* Mai sia! Ti dissi e dico 240b  
che l'odio e non sopporto di ascoltarti.  
Stattene solo, perché me ne vado.

Scena VI  
*Alfonso solo*

Almeno mi ha parlato, mentre prima  
al vedermi fuggiva, qual fanciullo  
spaventato da biscia velenosa 245  
o da nero fantasma impaurito.

Tranquilla ai miei dolori  
ha dato ascolto mentre sospiravo.  
Le lacrime non terse,  
raggrumate nel volto 250

mesto e cupo, ha sbirciato  
con un furtivo sguardo.

Questo, per quanto breve,  
è stato per me il massimo piacere,  
accanto starle solo quell'istante 255

tanto sempre bramato e mai goduto,  
onde del cuore mio sentisse il duolo.

Cambierà il mio destino  
forse, commosso da cotante pene. 260  
Cielo, se mai per sdegno incontenibile

imprecando ti offesi,  
ora sconfitto, vinto  
dalla clemenza tua, pieno di gioia  
tra i dolori ti esalto

per il sollievo datomi 265  
e rendo sempre grazie,  
della colpa pentito.

Scena VII  
*Clementina, Liso*

*Clem* O gioia! Nemmeno immaginavo  
istante sì piacevole e leggiadro. 270

Alla fine ti vedo almeno. È vero:  
sei tu, Liso, sparito tante volte!

Ti mostrasti e fuggisti in un sol attimo.  
Misera, sconsolata,  
sempre sulle tue tracce, ti raggiungo  
finalmente. Momento sospirato! 275

Un altro più felice, più carico di gioia  
 l'eternità mai vide.

Posso sperare amore dallo spirito  
 tuo fascinoso o mi tocca paure  
 soffrire ancor tra pene? E non avvenga 280  
 che il funesto pensiero affiori come  
 immagine nell'acqua. 282a

*Liso*                      Sempre tu, 282b  
 respiro della vita, mi amareggi  
 le gioie vagheggiate onde sei parca.

Sappi che sei dell'anima regina, 285  
 sostegno al viver mio,  
 tu l'eterno pensiero,  
 tu il bello, altero astro rifulgente  
 dove leggo le mie gioie future.

Se appresso a me venissi 290  
 in quelle solitudini inamene  
 dell'oscuro Farneto,  
 sola in cupe vallate col tuo gregge,  
 udresti che non altro

risuona per quei fiumi e boschi e valli 295  
 e poggi che una triste melodia  
 delle mie cornamuse che decantano  
 ognora la leggiadra Clementina.  
 Qualche volta dimentico le pecore.

Viene allora Menito, 300  
 addestrato a lambirmi con la lingua,  
 con la zampa a toccarmi, e mi par d'essere  
 ridesto da un letargo. Il gregge aduno,  
 assorto nel pensiero

della bellezza tua alta e leggiadra. 305  
 Ed il cuore ti spinge  
 a chiedere se t'amo?  
 Se m'ami, come me non l'hai mostrato.

*Clem* Non sai che il cuore ardente 310  
 sempre cova sospetti  
 e presente paure.  
 Diffidenza è nel fato degli amanti.

E vivono in sospiri,  
 gelosie, dal sereno  
 riposo ognor banditi, con un fremito 315  
 in petto che l'anima corrode  
 e in eterno pietà non ha né mostra.  
 Guarda giù al fiume. Ecco  
 che viene qui Kushedra.

Mi avvicinò altra volta 320  
 a chiedermi pian piano se ti amassi.  
 Glielo negai, ma ora

soli ci ha scorti e dire  
di no non serve. Viene di buon passo. 325  
L' aspettiamo o filiamo?  
*Liso* Restiamo qui per dirle  
che per la prima volta  
ci capita d'imbatterci col gregge  
l'uno nell'altra in mezzo a questi boschi.

Scena VIII  
*Kushedra e detti*

*Kush* Beati piccioncini, sempre gioia 330  
abbiate! Per voi fa germogliare  
or la natura i fiori variopinti  
e chiari e verdeggianti i prati erbosi

ostenta. Non per noi  
misere vecchie ormai 335  
tramontate cui solo la memoria  
delle gioie godute  
resta, sogno volante.

Almeno mi solleva  
l'amore di voi giovani, perché 340  
a te più, Clementina, voglio bene.

*Clem* Kushedra, grazie rendo,  
quante più ne ho nel cuore,  
per l'amor che mi porti. Ma perdonami,  
se ti ho contristata: son fanciulla 345  
e non so quel che faccio  
e bene ancora non conosco amore.

*Kush* Siete proprio ragazzi. Vi perdono.  
Ai miei verdi anni agivo così anch'io  
e volendo celare il fuoco in petto, 350  
ancor più lo svelavo

e lo mettevo in mostra  
e un posto non trovavo ove il mio bene  
potessi rimirare  
che con dispetto odioso 355  
il piacere concessomi inaspriva.

Uomo savio o vegliarda  
non ebbi a consigliarmi  
come voi, cui felice  
gioioso il fato, non funesto, arride. 360

*Liso* Kushedra, ci hai stregati coi tuoi detti  
e, inavvertita, il cuore ci hai scoperto,  
penetrando a tuo genio nei recessi  
intimi della mente.  
Hai scorto il nostro amore, 365  
sai ch'ogni mio respiro

sarà per la fanciulla  
 che mi sta accanto, benché i genitori  
 mi vietino guardare lei che solo  
 morte spietata può 370  
 dal cuore strapparmela, altrimenti  
 non la scordo un istante.

*Kush* Lingua non dice quanto sente il cuore,  
 ma, avendola battuta, quanto lunga 375  
 sia questa via ben so, mentre la mostra  
 corta l'amore e in seguito spinosa  
 la sperimenta il giovane.  
 Bandiamo dal petto la paura  
 e non dimentichiamo 380  
 che il tempo intacca monti, boschi e fiumi,  
 valli fa i monti e le vallate alture,  
 e fede da speranza sostenuta  
 infine approda a gioia sospirata.  
 Per quanto può, non vi lascia il mio aiuto  
 e ai tuoi bisbiglierò 385  
 calme parole onde abbiano piacere  
 per questo matrimonio. Ogni mio sforzo  
 a piegarne il volere sarà volto.

*Clem* Quel tanto di bene che ci fai  
 Dio te lo rende già nella vecchiaia. 390  
*Kush* Ah, non m'avete conosciuto l'anima.  
 È questa la mia gioia, il mio piacere:  
 esser utile ai giovani del mondo.  
 E di più mi trascina 395  
 amor che in uno vi ha legato i cuori  
 e gioia avrò soltanto  
 sposi al vedervi, in fastose nozze.  
 Amatevi e sperate,  
 ché il tempo viene, quando il godimento 400  
 cancellerà le ombre del passato.

*Liso* Clementina, non senti come abbaia  
 Menito nella valle. Forse è uscito  
 il lupo nel pianoro dal Farneto.  
 Andiamo! Ci scuserà Kushedra,  
 altrimenti dilania le pecore la belva. 405  
*Kush* Ogni bene vi avvenga a vostro genio  
 e mai dal petto fugga la letizia  
 dell'amore sognato.

Scena IX  
*Kushedra sola*

Così vi voglio. L'anima mi ride  
 come ride alla iena, quando adocchia la preda. 410

Tempo è ormai che mi vendichi  
 delle pene sofferte  
 per l'onta che dal perfido subii  
 malvagio Menalippo. Ho conosciuto, 415  
 visto con gli occhi, toccato con mano  
 l'amore che consuma  
 i due ed ho accostato legna al fuoco,  
 perché attizzato arda con più foga.  
 Miseri, siete involti in un garbuglio  
 spietato dove vi intricate, al muovervi, 420  
 più di prima. In inganno il dolce eloquio  
 vi ha tratti che ora il tossico propina.

## Atto II

### Scena I

#### *Sofia e poi Kushedra*

*Sof* O valli, monti, poggi, boschi, macchie,  
 pianure, rive, fiumi, laghi, fonti,  
 arbusti, piante, erbe, fiori, il putto 425  
 non avete invidioso che vi involi  
 la quiete onde magnanima natura  
 vi dà felicità. Sempre sereni  
 senza travagli godete la vita,  
 dono del Dio possente. 430  
 Al passar della brezza, in gioia disciogliete  
 un riso che risana le ferite  
 del nevoso rovaio e, se al mattino  
 dà il benvenuto la pernice in canto  
 e l'uccello sul ramo dell'arbusto 435  
 scuote le penne e al gorgheggio s'addestra  
 con cui saluta il giorno, voi rallegrano,  
 non mai la derelitta, cui dimora  
 nel petto, fosco e iniquo,  
 rabbioso amor che in cibo non sa porgerle 440  
 altro più che sospiri,  
 pianti, pene e paure.

[.....]

## N O T E

- 9 ruonja, ma al v. 14 ruare. In questo testo i due dittonghi si alternano.
- 17 pasmes. Equivale a *pasures*.
- 22 qeshën] qeshin.
- 27-28 Costruzione: *u kam të shurbenem aqë*.
- 33 të jeshë. Spesso l'autore usa il congiuntivo con il valore di futuro.
- 39 Qui, come anche ai versi 89, 143, 265, 344, 389, 432, il Santori omette il pronome relativo. Il fenomeno si riscontra anche nella *Neomenia*.
- 41 trima = giovanili.
- 49 i qeshën e dheu. Anastrofe.
- 59 dhjanemon. Dal greco *dianemō* = distribuire.
- 62 Jo di, jo dua. Correttamente: *s' di, nëng di*.
- 63 pjaxhëret] pjakëret (grafia originale). *Pjaxhëret e spjaxhër'*: la desinenza è presente solo nel primo termine.
- 80 Qui e al verso 425 ritorna l'immagine mitologica di Eros già presente in alcuni cori della *Neomenia*.
- 81 pasosme = eternità. Termine coniato dal Santori, come il *sësosma* del v. 276, di uguale significato.
- 86 Per l'immagine del putto Eros si confronti l'inizio della *Neomenia*.
- 91 shtiti. In sostituzione di un precedente *dhezi*.
- 97 shurdhurë] sciyrdury (grafia originale).
- 111 ndomos = mos nëng.
- 112 ghrëllë. Per la grafia cfr. G. De Rada, *Skanderbeku i pafân*, I 4 150. Il Santori (anche ai versi 164, 200 e 315) attribuisce all'aggettivo il significato di *lontano* e non, come nel De Rada, quello di *fievole*.
- 118 mund jam. Correttamente: *mund t' jem*.
- 120 finxhon'. Apocope per *finxhonën*.
- 127 stespasi. Grafia presente anche ai versi 188, 201, 225 (stespasuome), 280. Nella *Neomenia* (v. 705) il Santori scrive *sctepassii (shtepasi)*.
- 133 m' e] me me.
- 162a vëdiqe = morta.
- 172 më] më.
- 182 lepothmeva. Dal greco *lipothymēō*.
- 200 ninen... t' e] nenen...fe.
- 201 In questo testo le forme *durojnë* e *dhurojnë* si alternano.
- 211 tramaksa. Equivale a *tramaksura*.
- 220 lutëm = affamato. Dal calabrese.
- 226 qiëllë. Dittongo ascendente che rende possibile la rima con il *gjellë* del verso precedente.
- 232-261 La trascrizione è stata in più punti quanto mai ardua per le condizioni in cui si presentava l'originale. A renderla possibile è valsa la traduzione italiana (in versi) del Santori.
- 246 lugadhe, fantasma. In Albania, *lugat*.
- 284 onjaqë = ogni tanto. Formazione ibrida.
- 292 Farneto. Località campestre tra Santa Caterina Albanese e Roggiano Gravina.
- 297 më] më.
- 304 shprisha. Equivale a *shprishura*.
- 309 [ti]. L'integrazione è resa necessaria dalla metrica.
- 310 trandakse. Equivale a *trandaksure*.
- 362 dojim] dojin.
379. Sulla scorta della traduzione dello stesso Santori elimino il *namurinë* posto alla fine del verso.
- 397 dhëndërra] dyndura (grafia originale). La correzione si impone per ragioni metriche.
- 433 thellëza] thelluza.
- 435 llasimisurë. Gerundio non preceduto da *tue* (*tuke, duke*), secondo un uso frequente nello *Skanderbeku i pafân* del De Rada.

\* \* \*

Nel monologo di Sofia, dal v. 100 al v. 120, il Santori adotta la tecnica dell'eco. Sofia leva il suo lamento tra pendii e dirupi.



Ad ogni frase l'eco le restituisce, contraffacendola, una parola (in un caso una serie di parole) che la ragazza riprende nella frase seguente: *lipsi ≈ fuqi; nodhjon ≈ rrangon; zilize ≈ njize; sqep te ndina ≈ Kllemendina; sisonja ≈ donje; vate ≈ fate; gazore ≈ ambnore; brezon ≈ finxhon*'.

Si noti la catena degli amori infelici: Alfonso ama, non riamato, Sofia, che ama, non riamata, Liso, che a sua volta ama, senza sapere di esserne riamato, Clementina.

6 luglio 2013